

**VENDIM**  
**Nr.256, datë 23.3.2011**

**PËR KALIMIN E DISA PASURIVE TË NDODHURA NË ZONËN KADASTRALE NR.8512 TË BASHKISË DURRËS, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.536, DATË 1.5.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DURRËS, TË QARKUT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pikat 3, 10, 12, 13, 15/c dhe 16, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Revokimin e së drejtës së pronësisë për pronat me numrat rendorë 216, 217, 218, 219, 227, 228, 242, 244, si dhe të pronës me numrin rendor 1119, ndodhur në zonën kadastrale nr.8518, me nr.pasurie 46/18 dhe 46/29, me sipërfaqe 1348 (një mijë e treqind e dyzet e tetë) m<sup>2</sup>, të miratuara me vendimin nr.536, datë 1.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit”.

2. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike të shtetit, të ndodhura në zonën kadastrale nr.8518, me nr.pasurie 24/35, 26/32 dhe 46/22, sipas formularëve që i bashkëlidhen këtij vendimi. Lista që përbëhet nga 3 (fletë), fillon me numrin 1 (një) dhe mbaron me numrin 13 (trembëdhjetë).

3. Kalimin e pasurive të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për ndërtimin dhe shitjen e banesave, në zbatim të politikave sociale të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

4. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të lidhë kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, të përcaktuar në listat që i bashkëlidhen këtij vendimi, që përbëhen nga 23 (njëzet e tre) fletë, sipas kushteve të privatizimit, të përcaktuara me udhëzimin nr.22, datë 12.10.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

5. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Brendshëm, Kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**